| NJOFTIM PUNËSIMI | |
|---|---|
| **Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK** | Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura". Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë.Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësoj për një vend pune: **Specialist/e pranë Sektorit Menaxhimit të Kontratave në Drejtorinë e Shitjes** nisur nga data më e afërt. Punëmarrësi i ri do të jetë përgjegjës në ndjekjen e procesit të menaxhimit të kontratave të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për konsumatorët familjarë, privatë dhe buxhetorë si dhe në procesin e menaxhimit të kontratave të furnizimit me ujë me shumicë, e furnizimit me ujë nëpërmjet autoboteve, e largimit të ujërave të ndotura dhe shërbime të tjera që ofron Shoqëria. |
| **Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:** | • Siguron që procedurat e menaxhimit të kontratave të kryhen sipas manualit të miratuar të procedurave.<br>• Kryen verifikimet e nevojshme për dokumentacionin e paraqitur nga abonentët për lidhjen e kontratave.<br>• Asiston në trajtimin e ndryshimeve dhe saktësimeve të të dhënave të klientëve (emri, mbiemri, adresa, etj.).<br>• Përgatit dokumentacionin për pezullime, mbyllje dhe ndryshime të kontratave dhe kryen verifikimet paraprake përkatëse.<br>• Siguron që abonentët të pajisen me informacion të saktë dhe të plotë në lidhje me statusin e kontratave të tyre.<br>• Trajton kërkesat për historikun e hapjes së kontratave, dokumentacionin e paraqitur nga klienti për lidhje kontrate duke kryer verifikimet e nevojshme.<br>• Kryen verifikime dhe ndjek deri në mbyllje të gjithë procedurën e trajtimit të kërkesave dhe ankesave të abonentëve lidhur me kontratat, ndryshimet e emrit, pezullimet, etj.<br>• Verifikon arkëtimet e pagesave të kryera me bankë ose palë të treta për shërbime si çelje kontrate, pikë lidhje, furnizimit me ujë me shumicë, për furnizimin me ujë nëpërmjet autoboteve, për largimin e ujërave të ndotura dhe për shërbime të tjera që ofron Shoqëria. |

| | |
|---|---|
| | • Mbledh dhe analizon të dhënat lidhur me kontratat e reja dhe ndryshimet e kontratave ekzistuese.<br>• Përgatit statistika krahasimore të lidhjes së kontratave të reja sipas periudhave kohore dhe kategorive të konsumatorëve.<br>• Ndihmon në analizimin e ndikimit të kontratave të reja dhe të mbyllura në faturim.<br>• Ndihmon në hartimin e planeve për lidhjen e kontratave të reja.<br>• Përgatit evidenca dhe raporte për kontratat e mbyllura, të pezulluara dhe në proces.<br>• Administron evidencat e kontratave për çdo NjO, duke përditësuar rregullisht të dhënat në sistem.<br>• Përgatit dokumentacionin dhe ndihmon Përgjegjësin e Sektorit të Menaxhimit të Kontratave në kryerjen e detyrave të përditshme administrative të lidhura me menaxhimin e kontratave.<br>• Siguron që të gjitha procedurat dhe dokumentet të jenë të përputhshme me rregulloret dhe udhëzimet e Shoqërisë. |
| **Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:** | • Preferohet kandidat me profil juridik.<br>• Eksperienca pune të mëparshme.<br>• Librezë e Punës<br>• Certifikatë Familjare<br>• Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës<br>• Dy fotografi<br>• Fotokopje e Diplomës me listën e notave e noterizuar<br>• Dëshmi Penaliteti<br>• Raporti Mjekësor<br>• Vërtetim Vendbanimi |
| **Kushtet e punës:** | • Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur.<br>• Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani. |
| • Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 09.07.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar. | |